REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA MALËSI E MADHE
KËSHILLI

Nr.802/2 prot

Koplik më:06/05/2022

**V E N D I M**

**Nr 14, Datë 26 / 04 / 2022**

**PËR**

**MIRATIMIN E PROJEKTIT MES BASHKISË MALËSI E MADHE DHE FONDACIONI I ZHVILLIMIT RAJONAL SHQIPËRI ,TRANSFERIMIN E FONDIT BRENDA BUXHETIT TE MIRATUAR PË VITIN 2022,DHE MIRATIMIN E BASHKËFINANCIMIT TË PROJEKTIT MES BASHKISË MALËSI E MADHE DHE FONDACIONI I ZHVILLIMIT RAJONAL SHQIPËRI PËR BASHKËFINANCIMIN E PROJEKTIT 'PËRMIRËSIMI I OFERTES TURISTIKE DHE RRITJA E SEZONALITETIT NË FSHATRAT LEPUSHE DHE VERMOSH"**

Këshilli Bashkiak Malësi e Madhe në mbledhjen e Këshillit të datës 26.04.2022, në mbështetje të Ligjit nr. 139/2015 "Për Vetëqeverisjen Vendore" ne ligjin nr..9936 dt.26.06.2008 "Per Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republiken e Shqipërisë",të ndryshuar,në ligjin nr.68/2017 "Për Financat e Veteqeverisjes Vendore, në VKB nr.70 dt. 29.12.2021 "Për Miratimin e Buxhetit të vitit 2022 dhe programit buxhetor afatmesem 2022-2024 të Bashkise Malësi e Madhe ,dhe në relacionin mbi bashkëfinancimin e projektit te "Fondacioni i Zhvillimit Rajonal Shqiperi"

**V E N D O S I:**

1. Miratimin e projektit mes Bashkisë Malësi e Madhe dhe Fondacioni i Zhvillimit Rajonal Shqipëri.
2. Transferimin e fondit brenda buxhetit të miratuar pë vitin 2022 nga programi 01110 "Planifikimi i Menaxhimit dhe Administrimit" në Shumen 3.000.000 leke ,tek Programi "Zhvillimi i Turizmit"
3. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Kryetari i Bashkisë Malësi e Madhe.
4. Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të nenit 55 pika 6 të ligjit nr. 139/2015 "Për Veteqeverisjen Vendore"

KRYETAR
Ilir Halaj

SEKRETAR
Emirjan Hasmujaj
Miratuar me 26.04.2022
Vota Pro 22
Vota Kunder 0
Vota Abstenim 0
Zbardhur me datë 28.04.2022

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA MALËSI E MADHE
DREJTORIA JURIDIKE DHE MENAXHIMIT TË ASETEVE
SEKTORI JURIDIK

Nr. 902 .prot

Koplik më: 24/ 03 /2022

**PROJEKT-VENDIM**

**Nr____, Datë ___/___/2022**

**PËR**

**TRANSFERIMIN E FONDIT BRENDA BUXHETIT TE MIRATUAR PË VITIN 2022,DHE MIRATIMIN E BASHKËFINANCIMIT TË PROJEKTIT MES BASHKISË MALËSI E MADHE DHE FONDACIONI I ZHVILLIMIT RAJONAL SHQIPËRI PËR BASHKËFINANCIMIN E PROJEKTIT 'PËRMIRËSIMI I OFERTES TURISTIKE DHE RRITJA E SEZONALITETITNË FSHATRAT LEPUSHE DHE VERMOSH"**

Kryetari i Bashkisë Malësi e Madhe , në mbështetje të Ligjit nr. 139/2015 "Për Vetëqeverisjen Vendore" ne ligjin nr..9936 dt.26.06.2008 "Per Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republiken e Shqipërisë",të ndryshuar,në ligjin nr.68/2017 "Për Financat e Veteqeverisjes Vendore, në VKB nr. 70 dt. 29.12.2021"Për Miratimin e Bxhetit të vitit 2022 dhe programit buxhetor afatmesem 2022-2024 të Bashkise Malësi e Madhe ,dhe në relacionin mbi bashkëfinancimin e projektit te "Fondacioni i Zhvillimit Rajonal Shqiperi"

**VENDOSI:**

Që ti propozojë Këshillittë Bashkisë Malësi Madhe që të miratojë:

I- Transferimin e fondit brenda buxhetit te miratuar pë vitin 2022 nga programi 01110, artikulli 231( bashkëfinancimi I projektit me kod 1300047), "Planifikimi i Menaxhimit dhe Administrimit" pakësohet në Shumen 3.000.000 leke dhekalon nę Programin "Zhvillimi i Turizmit" 04760 artikulli 231.

II- Miratimin ë projektit mes bashkisë Malësi e Madhe dhe Fondacioni i Zhvillimit Rajonal Shqipëri.

III- Për zbatimin e këtij vendimingarkohet Kryetari i Bashkisë Malësi e Madhe.

IV- Ky vendim hyn ne fuqi menjëherë.

Faleminderit për mirëkuptimin!

KRYETAR

TONIN MARINAJ

**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**
**BASHKIA MALESI E MADHE**
**DREJTORIA JURIDIKE DHE E MENAXHIMIT TE ASETEVE**
**SEKTORI JURIDIK**

Nr.802/1 Prot. Koplik ,më 24/03/2022

**Relacion**

**Miratimin e transferimit të fondit të miratuar në buxhetin e vitit 2022 nga programi Planifikimi i Menaxhimit dhe Administrimit në programin Programin Zhvillim i Turizimit dhe miratimin Bashkëfinancimit mes Bashkisë e Malësi e Madhe dhe Fondacionit të Zhvillimit Rajonal Shqipëri të Projektit"Përmirësimi i ofertes turistike dhe rritja e sezonalitetit në fshatrat Lepushë dhe Vermosh"dhe transferimi I fondeve me qellim realizimin e ketij Investimi.**

Kryetari i Bashkisë Malësi e Madhe në mbështetje të ligjit 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", nenit 64 germa e dhe neni 2:

**Të nderuar këshilltarë**

Më lejoni tju paraqes relacionin për Miratimin e transferimit të fondit të miratuar ne buxhetin e vitit 2022 nga programi Planifikimi i Menaxhimit dhe Administrimit në programin Programin Zhvillim i Turizimit dhe miratimin Bashkëfinancimit mes Bashkisë e Malësi e Madhe dhe Fondacionit të Zhvillimit Rajonal Shqipëri të Projektit"Përmirësimi i ofertes turistike dhe rritja e sezonalitetit në fshatrat Lepushë dhe Vermosh"dhe transferimi i fondeve me qellim realizimin e ketij Investimi

Ky project "Përmirësimi i ofertes turistike dhe rritja e sezonalitetit në fshatrat Lepushë dhe Vermosh" ka për qëllim të ndihmoje financiarisht investimin e projektit dhe bashkefinancimin në shumën 15.000.000(pesëmbedhjetë million)Lekë nga Fondacionit të Zhvillimit Rajonal Shqipëri dhe Bashkia Malësi e Madhe në vlerën 3.000.000(tremilion)Lekë.

Projekti ka për qellim realizimin e nje investimi në Njësinë Admnistrative Kelmend,i cili do ndihmojë turizmin e zones dhe shfrytëzimin gjatë gjithë vitit të resurseve pasi bëhet fjalë për realizimin e një teleferiku investim shume i rëndesishem dhe veçantë deri tani në vendin tone.

Në këtë projekt Bashkia Malesi e Madhe do jete plotesisht përgjegjese ne zbatimin,menaxhimin mbikqyrjen e projektit dhe per realizimin e ketij projekti.

**Ju faleminderit për bashkëpunimin tuaj.**

**KRYETAR**
**TONIN MARINAJ**

Adresa:Koplik-Qender tel 021122650/2651 e-mail:bashkiamalesiemadhe@hotmail.com

PZHRSH - Thirrje për Aplikime për Skemën e Zhvillimit Rajonal dhe Kohezionin

Thirrja për Aplikime Shtojca B - Buxheti

1. Buxheti për projektin e propozuar

| Kosto | E gjithë periudha | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | Njësia matëse | Sasia | Kosto/njësi | Kosto totale neto | TVSH | Totali | Financimi PZHRSH | Bashkë-financimi Aplikantit (ne koston totale neto) | Bashkë-financimi Aplikantit (TVSH) | Bashkë-financim nga Partner të asociuar (Përfshi TVSH) |
| 1 | 2 | 3 | 4 | 5 | 6 | 7 (5+6) | 9 | 10 | 11 | 12 |
| 1.Pajisje | | | | | | | | | | |
| 1.1 Pajisje dhe Instalim Teleferiku 100 m | cope | 1 | 8,333,355 | 8,333,355 | 1,666,671 | 10,000,026 | 8,333,355 | | 1,666,671 | |
| 1.2 Biciklеta offroad | cope | 5 | 60,000 | 300,000 | 60,000 | 360,000 | 300,000 | | 60,000 | |
| 1.3 Motore malore me kater rrota | cope | 2 | 250,000 | 500,000 | 100,000 | 600,000 | 500,000 | | 100,000 | |
| **Pajisje Total** | | | | **9,133,355** | **1,826,671** | **10,960,026** | **9,133,355** | | **1,826,671** | |
| | | | | | | | | | | |
| **2. Sherbime** | | | | | | | | | | |
| 2.1 Kontrate sherbimi per zhvillimin e aktiviteteve/eventeve lokale | Kontrate sherbimi | 1 | | 2,866,645 | 573,329 | 3,439,974 | 2,866,645 | | 573,329 | |
| 2.1.1 *Kontrate sherbimi Eventi " Zanat e Maleve"* | | 1 | 1,146,658 | 1,146,658 | 229,332 | 1,375,989.60 | 1,146,658 | | 229,332 | |
| 2.1.2 *Kontrate sherbimi eventi permbylles* | | 1 | 1,719,987 | 1,719,987 | 343,997 | 2,063,984.40 | 1,719,987 | | 343,997 | |
| 2.2 Kontrate konsulence " Mbeshtetje e Bashkise per planifikimin strategjik dhe organizim te programit te promovimit turistik" | dite pune | 200 | 15,000 | 3,000,000 | 600,000 | 3,600,000 | 3,000,000 | | 600,000 | |
| **Shërbime Total** | | | **2,881,645** | **5,866,645** | **1,173,329** | **7,039,974** | **5,866,645** | | **1,173,329** | |
| | | | | | | | | | | |
| **Total** | | | | **15,000,000** | **3,000,000** | **18,000,000** | **15,000,000** | | **3,000,000** | |

Aplikanti kryesor

| | |
|---|---|
| Emri | TONIN MARINAJ |
| Firma | |
| Data | 11.11.2021 |

REPUBLIKA E SHQIPËRISË - BASHKIA MALËSI E MADHE

## 2. Justifikimi i Buxhetit për Projektin

| Kostot | Shpjegime për zërat e buxhetit | Justifikimi i vlerësimit të kostove |
|---|---|---|
| 1.Pajisje | | |
| 1.1. Pajisje dhe instalim teleferiku 100 m Lepushe (Malesi e Madhe) | Realizimi i ketij investimi vleresohet si mjaft i rendesishem ne arritjen e objektivave te vendosur ne kete projekt, vecanerisht ne realizimin e drejteperdrejte te Objektivit specifik nr.2 sic eshte "Përmirësimi dhe diversifikimini e ofertës turistike ekzistuese ne fshatrat Lëpushë dhe Vermosh" si dhe objektivit nr.3 "Zgjerimin e sezonit turistik duke perfshire dhe aktivitetet dimerore". Duke qene nje atraksion i ri dhe i vetem ne zone konsiderohet si nje nga komponentet me te rendesishem te projektit dhe do konsiderohet nje risi ne zone, vecanerisht gjate periudhes se dimrit. | Analizat per kostot jane bere duke marre cmimet mesatare te shitjeve te kompanive kryesore shqiptare qe shesin online. |
| 1.2 Bicikleta offroad<br>1.3 Motore me kater rrota | Blerja e ketyre pajisjeve te klasifikuara ne zerat e busheti 2.1 dhe 2.2 do te plotesojne nderhyrjet e parashikuara ne dy itineraret e reja te cilat do te promovohen ne sezonin e ardhshem. Keto pajisje vleresohet si mjete mjaft te nevojshem ne funksion te nje promovimi sa me te mire te zones. Keto pajisje do te jene ne dispozicion te turisteve dhe do te vendosen ne QZHT Vermosh. Njekohesisht do te sherbejne edhe si nje mundesi me e mire per levizjen e turisteve ne disa pika atraktive te zones, duke rritur diversifikimin e ofertes. Pajisjet do te ndihmojne ne permbushjen e objektivit nr. | Analizat per kostot jane bere duke marre cmimet mesatare te shitjeve te kompanive kryesore shqiptare qe shesin produkte te tilla. |
| 2. Shërbime | | |
| 2.1 Kontrate sherbimi per zhvillimin e aktiviteteve/ eventeve lokale | Permes kontraktimit te nje operatori me pervoje ne kete tipologji aktivitetesh, parashikohet nje rezultat me i mire i arritur persa i perket promovimit te vlerave turistike te zones. Keto aktivitete do te sherbejne per permbushjen e objektivit specifik nr.2 "Përmirësimi dhe diversifikimi i ofertës turistike ekzistuese ne fshatrat Lëpushë dhe Vermosh" si dhe vecanerisht objektivin specifik nr.5 "Zgjerimi i tregut nëpërmjet promovimit te ofertës turistike dhe produkteve lokale". Keto aktivitete do te jene ne perputhje me programimin dhe dizenjimin e kryer nga konsulentet qe do te hartojne strategjine e marketingut dhe promocionit.<br>Ketu jane marre paresysh realizimi i dy eventeve perkatesisht: 1. Zana e Maleve i cili mendohet te zhvillohet ne muajin qershor 2. Eventi permbylles, ku do inagurohet Zip line dhe itineraret turistike | Analizat per kostot jane bere duke marre ne konsiderate kontrata te ngjashme sherbimi te lidhura nga Bashkia Malesi e Madhe, te aktiviteteve te realizuara me pare. |
| 2.2 Kontrate konsulence "Mbeshtetje e Bashkise per planifikimin strategjik dhe organizim te programit te promovimit turistik" | Kjo kontrate eshte parashikuar te lidhet me partnerin e perzgjedhur nga Bashkia, nje organizate e shoqerise civile me eksperiencen dhe ekspertizen e nevojshme. Ky partneritet do te siguroje mbeshtetjen dhe forcimin e rolit te bashkise ne fushen e turizmit. Permes zbatimit te modeleve dhe praktikave me te mira ne rajon dhe me gjere, organizata do te pergatise dokumente strategjike te cilet do ti sherbejne bashkise, per ngritjen e politikave dhe mbeshtetjen e zhvillimit te turizmit ne zone, si nje potencial i rendesishem zhvillimi. Njekohesisht rrjeti i vullnetareve te organizates do te perfshihet ne menyre te drejteperdrejte ne kryerjen e aktiviteteve ne terren, me qellim nxitjen e nderveprimit social. Permes kesaj kontrate konsulence bashkise do ti vendoset ne perdorim nje database i perditesuar dhe i plote me te gjithe informacion e nevojshem per menaxhimin sa me te mire te ketij destinacioni. Ne kete kontrate jane perfshire dhe pregatitja e itinerareve digitale per udhetimet me bicikleta dhe motor me 4 rrota dhe harta digitale per atraksionet turistike e cila do pregatitet nga ekspertet e Assist Albania | Analizat per koston e ketij sherbimi jane bere duke marre ne konsiderate kontrata te ngjashme konsulence te alokuara nga Bashkia Malesia e Madhe, apo qe kane bashkepunuar me bashkine. |

Aplikanti kryesor

| | |
|---|---|
| Emri | TONIN MARINAJ |
| Firma | : |
| Data | 11.11.2021 |

REPUBLIKA E SHQIPËRISË - BASHKIA MALËSI E MADHE

3. TVSH - letër angazhim

Subjekti i kësaj letre angazhimi është në kuadrin e kapacitet financiar të aplikantit kryesor për të mbuluar Tatimin mbi Vlerën e Shtuar, meqënëse kjo e fundit nuk është një kosto e lejueshme për t'u financuar nga granti.

Aplikanti kryesor angazhohet të alokojë shumën e TVSH-së sikurse evidentuar në tabelën më poshtë në buxhetin e bashkisë për vitin 2022.

| Buxheti total i projektit | Financimi PZHRSH-së | Bashkë-financimi aplikantit | TVSH | Bashkë-financim nga Partner të asociuar (Përfshi VAT) |
|---|---|---|---|---|
| 18,000,000 | 15,000,000 | 3,000,000 | 3,000,000 | 0 |

**Aplikanti kryesor**

| | |
|---|---|
| Emri | TONIN MARINAJ |
| Firma | |
| Data | 11.11.2021 |

**Shënim: Si bashkëfinancim, aplikanti duhet minimalisht të sigurojë shumën e TVSH-së në**

# BASHKIA MALESI E MADHE

## SPECIFIKIME TEKNIKE

## TELEFERIK NE ZONEN MALORE, LEPUSHE.

## MALESI E MADHE



## SPECIFIKIMET TEKNIKE

**Teknologjia e perdorur:**

**Makineria perbehet nga:**

- Bazamente betoni tensionuese
- Suporte tensionuese per litarin mbajtes dhe terheqes
- Pulexho e makinerise
- Pulexho devijuese
- Rrote e dhembezuar motorike me frena
- Mbeshtetese e makinerise
- Frena emergjence me veprim direkt mbi pulexho
- Monitoruesi I pozicionit te pjeseve levizese.
- Pajisja e makinerise emergjente

Montimi i litarit mbajtes per stacionin e siperm dhe te poshtem

- Amortizator nen tension me dy celesa takimi secili
- Morseta litari mbajtes
- Morseta sigurie
- Unaza mbajtese sferike
- Konsuj ankorues te litarit mbajtes
- Udheheqes litari terheqes

**Pajisja elektrike**

Makineria do te mbrohet kundrejt mbishpejtesise, renies se tensionit, levizjeve te kthyeshme, keputjet e siguresave, humbja e fushes se veprimit, mbingarkesa, mbinxehja etj,.

Nje sistem i detajuar i vendndodhjes se demtimeve ne te dy stacionet.

Sistemi do te lejoje funksionimin automatic te Teleferikut.

Motori do te mbrohet kundrejt lageshtise (klasa me e larte e izolimit).

Pajisja elektrike do te jete e pershtatshme per funksionim zbuluar.

Pajisja elektrike do te mbrohet kundrejt nderprerjeve te shkurtra te energjise.

Tere kontrolli per makinerine do te parashikohet. Ne rastet e nje demtimi, instalimi do te mbyllet automatikisht dhe demtimi zbulohet ne menyre te shpejte.

Kontrolli i tensionit te ulet kerkohet per funksionimin e sistemit te teleferikut me tregues te dukshem ne cdo celes, shpejtesine e litarit, shpejtesine e eres, leven e dores per funksionimte frenave te sherbimit dhe frenave te emergjences.





**Te dhenat teknike te teleferikut**

| | | |
|---|---|---|
| 1. | Gjatesia ajrore e transportit | 100 m |
| 2. | Pika e poshtme e teleferikut (kuota) | 1359,6 m |
| 3. | Pika e siperme e teleferikut (kuota) | 1398,6 m |
| 4. | Disniveli i dy pikave (fillim/fund) i teleferikut | 40 m |
| 5. | Kendi i inklinimit te litarit | 30° |
| 6. | Diametri i litarit mbajtes | 36mm |
| 7. | Diametri i litarit terheqes | 36mm |
| 8. | Numri i kampatave (mbeshtetjeve) | 2 |
| 9. | Numri i kabinave/vagonave,karrocave etj,. | 15 |
| 10. | Kapaciteti | 300-350p/ore |
| 11. | Fuqia kryesore e instaluar | 100 kw |
| 12. | Fuqia secondare | 46 kw |

13. Shpejtesia e levizjes kryesore 2,3 m/s
14. Shpejtesia e levizjes ne stacionin fundor 0.5 m/s
15. Gjatesia e levizjes neper stacione 100 m

## Tipi i teleferikut (modeli i propozuar)





Ky model eshte nje dizajn i thjeshtuar qe perfshin nje suste spirale. Kjo zgjidhje shmang ferkimin e brendshem dhe garanton besueshmerine optimale ne lidhje me forcen e kapjes. Per operatorin, nje avantazh i dorezes se re moderne eshte se zhvendosja apo edhe heqja e kapjes mund te kryhet shpejt dhe lehte pa rrezikun e prishjes se cilesise se forces se kapjes.

Kjo eshte per shkak se kapja ne nofullen ne levizje mbetet e mbyllur.

Se fundmi gjuhet e reja dhe me moderne te kapjes sigurojne nje kalim te qete perms montimeve te rreshqitjes dhe kombinimit.

## Garancia

I garantuar nga data e nisjes (fillimit te punimit) dhe ne perputhje me kushtet e pergjithshme te dergesave per Kompanite e konstruksioneve te Teleferikeve ne industrine e ndertimit te makinave dhe konstruksionevete celikta.

Pajisja do te funksionoje ne menyre te sakte ne lidhje me udhezime te funksionimit.







Procesi i ndertimit te projektit

Me poshte nje pershkrim i shkurter i hapave te procesit:

- Vleresimi i vendndodhjes
- Dizajni
- Vleresimi nga eksperte te certifikuar
- Plani i rigjallerimit te zones
- Dizajni perfundimtar
- Testet dhe llogaritjet e forcave statike dhe dinamike
- Plani perfundimtar i ndertimit
- Ndertimi
- Inspektimet
- Perqasja me pronaret e objektit per rezultatin e ndertimeve

Plani i mirmbajtjes

Udhezimet e metejshme te mirmbajtjes pershkruhen ne manualin e perdoruesit dhe mirmbajtjes. Gjate periudhes se mbylljes dhe para hapjes se sezonit te ri do te zhvillohet procesi i mirmbajtjes.

- Pastrimi i zones
- Zevendesimi i pjeseve te lirshme dhe mekanike
- Vleresimi i zones
- Mirmbajtja dhe rregullimi
- Inspektimi nga nje organ i pavarur

Grupi i punes :

Ing. Gezim ISUFAJ

Ing. Julian NOKAJ